



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planiuar / Dërguar Prenjshëm/Prisato Received/Delivered	05-05-2023	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix
SKM8HCK	4420/2023	1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.546/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.546/2023 të datës 22.03.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Komunës së Drenasit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.05.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

*Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.546/2023 e datës 22.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, me datë 22.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit-Njoftimit me numër 01 Nr.400/01-12790 të datës 16.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale dhe aplikimi të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( *tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullos Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Drenasit. Ndërsa, Këshilli me datë 07.04.2023 ka pranuar shkresat e bashkëngjitura të lëndës.





Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2886/2023 të datës 22.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Njoftimin me numër 01 Nr.400/01-12790 të datës 16.03.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Dranasit; Vendimin me numër 01 Nr.117/02-10315 i datës 28.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.03.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 07.04.2023 Akt emërimit me numër të protokollit 01-120-8298 të datës 08.06.2012; Listën e pagave për muajin janar-2023; Listën e pagave për muajin shkurt 2023; Informimin/ Njoftimin me numër 01 Nr.181-48773 të datës 21.09.2022 për përfundimin e punësimit para datës së pensionimit; Kërkesën me numër 01-400/01-12790 të datës 14.03.2023 të parashtruar nga ankuesi tek Drejtoria për Administratë dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Drenasit; Fletedorzimin me numër 400/01-12790;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së është e pabazuar ankesa e ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedh së ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 03.06.2012 ka ushtruar detyrën e punës "Bibliotekist" në Komunën e Drenasit. Me tej nga shkresat e lëndës rrjedhë së ankuesit sipas Vendimit 01 Nr.117/02-10315 të datës 28.02.2023 të Kryetarit të Komunës së Drenasit, i është përfunduar marrëdhënia e punës me datë 04.03.2023 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. I njëjti me datë 14.03.2023 i është drejtuar më kërkesë Komunës së Drenasit, për pagesën e një page përcjellëse pas pensionimit, ndërsa kjo e fundit përmes Shkresës me 01-Nr.400/01-12790 të datës 16.03.2023 ka njoftuar palën ankuese se me hyrjen në fuqi Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat e Sektorit Publik me datë 05 shkurt 2023 është shfuqizuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, me të cilin njihej e drejta e kompensimit të një page mujore të menjëhershme në vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit.

Ankuesi pas përgjigjes së datës 16.03.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës civil me pretendimin ankimor që ti njihet e drejta e një page mujore përcjellëse pas pensionimit.


Ne kuptim të vendosjes meritore Kolegji i Këshillit thekson faktin së Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 dhe si rrjedhojë me nenin 45 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar se: 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil; 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji. Andaj, duke qenë së ankuesi është pensionuar me datë 04.03.2023 pra pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit konstaton së Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit ka vepruar drejtë me rastin e nxjerrjes së aktit-njoftimit të kundërshtuar me ankesë, sepse Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk parasheh ndonjë pagesë apo kompensim me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të nëpunësit civil, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar ligjërisht.

Theksuar si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.546/2023

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

  
Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Drenasit;
- Arkivit të KPMSHCK-së

